

V E N D I M
Nr. 395, datë 15.8.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të nenit 29 pika 1, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Beratit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Beratit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 5 000 m2 truall, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 10 660 000 (dhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh.
4. Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, zëri “Investime”, t’i shtohet fondi prej 10 660 000 lekësh, i cili i pakësohet buxhetit të vitit 2002, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 112 000 (njëqind e dymbëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Bashkinë e Beratit, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 15-20 shtator 2002.
7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Financave, Prefektura e Qarkut të Beratit dhe Bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano